



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORË

NR.236 AKTI
DATA E ARDHJES 15.05.2014

NR.236 VENDIMI
DATA 28.05.2014

V E N D I M

"Për konfiskimin e sendit"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQITAR: LAURENT FUÇIA

Me pjesmarrjen e sekretares gjyqësore **Nilda Thanasko**, sot në Vlorë, më datë 28.05.2014, ora 12.15, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore jo publike, kërkesën penale me Nr.236 Akti, me palë:

KËRKUESE:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga Prokurori,

OBJEKTI:

Konfiskimin e mjetit lundrues "gomone", me ngjyrë gri, me mbishkrimin "MAXI MATRICA", e pamatrikulluar, me gjatësi 6.4 m, gjërësi 2.3 m, me dy motorrë, njëri model "ENVIRUDE" me fuqi motorrike 150 hp, ndërsa tjetri model "MARINER" me fuqi 15 hp.

BAZA LIGJORE:

Nenet 20, 22, 23, 24 dhe 31 të Ligjit Nr.8663, datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT".

Gjykata, pasi administroi aktet e ndodhura në dosjen gjyqësore, e

shqyrtoi çështjen në tërësi, dëgjoji diskutimet përfundimtare të palës kërkuese, e cila kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

VËREN:

Pala kërkuese, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka paraqitur përpara kësaj Gjykate kërkesën me objektin dhe bazën ligjore të prezantuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Referuar shkresës Nr.836 Prot., datë 14.05.2014, me lëndë "Dërgohen materialet për vlerësim të sekuestros mbi një mjet lundrues", lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Vlorë, rezulton se i janë paraqitur Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, materialet procedurale në lidhje me sekuestrimin e një mjeti lundrues, të llojit "gomone" me ngjyrë gri, me mbishkrimin "MAXI MATRICA", e pamatrikulluar, me gjatësi 6.4 m, gjërësi 2.3 m, me dy motorrë, njëri model "ENVIRUDE" me fuqi motorrike 150 hp, ndërsa tjetri model "MARINER" me fuqi 15 hp.

Nga materiali procedural si më sipër, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Vlorë, ka rezultuar se, në datën 10.05.2014, rreth orës 22.30 min, mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative nga ana e sektorit të shërbimeve operacionale dhe hetimit Vlorë, është marrë dijeni në lidhje fshehjen e një mjeti lundrues i ndodhur në zonën e Martinës Fier, i cili dyshohej se do të përdorej për trafikimin e lëndëve narkotike në drejtim të Italisë.

Në këto kushte, u realizua kontrolli i vendit të dyshuar, nga ku, rreth 1.5 km larg nga fshati Martin, buzë Lumit Vjosa, u gjend i fshehur një mjet lundrues "Gomone", me gjatësi 6.4 m, i cili u transportua nëpërmjet detit për në pikën e bllokimit në stacionin e PKM-Triport, Zvërnec, nga ku, pas verifikimeve përkatëse, ka rezultuar e pa pajisur me dokumentacionin e nevojshëm.

Pas këtij veprimi, po në datën 10.05.2014, është mbajtur procesverbali "Për sekuestrimin e mjetit lundrues" të llojit "gomone" me ngjyrë gri, me mbishkrimin "MAXI MATRICA", e pamatrikulluar, me gjatësi 6.4 m, gjërësi 2.3 m, me dy motorrë, njëri model "ENVIRUDE" me fuqi motorrike 150 hp, ndërsa tjetri model "MARINER" me fuqi 15 hp, veprim i cili është vleftësuar si i ligjshëm me vendimin e prokurorit të datës 14.05.2014.

Për sa sipër, në datën 14.05.2014, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është kryer regjistrimi i procedimit penal Nr.814 dhe është paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesa për konfiskimin e mjetit lundrues, të llojit "gomone"

me ngjyrë gri, me mbishkrimin "MAXI MATRICA", e pamatrikulluar, me gjatësi 6.4 m, gjërësi 2.3 m, me dy motorrë, njëri model "ENVIRUDE" me fuqi motorrike 150 hp, ndërsa tjetri model "MARINER" me fuqi 15 hp.

Neni 20 i Ligjit Nr.8663, datë 18.09.2000 parashikon se: "1. Mospasja në bordin e mjetit lundrues, të dokumenteve të përmendura në nenin 10, gjatë kontrollit të policisë, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me një gjobë nga 10.000 (dhjetë mijë) deri në 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.2. Në rastin e parashikuar në pikën 1, mjeti lundrues i nënshtrohet bllokimit administrativ deri në verifikimin e identitetit të pronarit, të bashkëpronarëve, të mbajtësit, të zotëruesit ose të drejtuesit të mjetit lundrues.3. Në procesverbalin e konstatimit të shkeljes, një kopje e të cilit i jepet zotëruesit ose mbajtësit të mjetit lundrues, duhet të shënohet detyrimi i pronarit, i bashkëpronarëve ose i drejtuesit të mjetit për t'ia paraqitur dokumentet e mësipërme, brenda 3 (tri) ditëve, zyrës së policisë kufitare që e procedon.4. Nëse dokumentet nuk paraqiten brenda afatit të parashikuar në pikën e mësipërme, mjeti lundrues i nënshtrohet bllokimit administrativ për 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë me urdhër të drejtuesit të zyrës së policisë kufitare kompetente. Shpenzimet e ruajtjes, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Rendit Publik, janë në ngarkim të kundërvajtësit.5. Nëse dokumentet nuk paraqiten edhe brenda këtij afati, mjeti lundrues konfiskohet".

Neni 24 i Ligjit Nr.8663, datë 18.09.2000 parashikon se: 1. Pronësia, mbajtja ose zotërimi i një mjeti lundrues, objekt i këtij ligji, të pamatrikulluar ose të peregjistruar, sipas nenit 5, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë), deri në 200.000 (dyqind mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues.2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, i cili ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në paragrafët 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.3. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

Neni 31 i Ligjit Nr.8663, datë 18.09.2000 parashikon se: 3. Në çdo rast, oficeri i policisë gjyqësore harton në tri kopje procesverbalin e kontrollit dhe të sekuestrimit të mundshëm të mjetit lundrues si element prove i veprës penale, ia dorëzon një kopje të procesverbalit të interesuarit nëse është i pranishëm, një kopje ia dërgon prokurorit përgjegjës dhe kopjen e tretë e arkivon në aktet e zyrës.4. Në procesverbalin e parashikuar në pikën 3 duhet të shënohen deklaratat e çastit të bëra nga personi, nëse është i pranishëm, ndaj të cilit është bërë kontrolli.5. Personit, të përmendur në pikën e mësipërme, i bëhet e

ditur para fillimit të veprimeve, se mund të kërkojë mbrojtjen me avokat.6. Oficeri i policisë gjyqësore i dërgon prokurorit procesverbalin e mësipërm brenda dyzet e tetë orëve, i cili brenda dyzet e tetë orëve në vijim vlerëson kontrollin..”

Gjykata çmon se, nga ballafaqimi i fakteve objekt i kërkesës së paraqitur përpara saj, me dispozitat e ligjit të posaçëm (*lex specialis*), rezulton se, në rastin konkret, nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore, janë respektuar më rigorozitet afatet dhe mënyra e kryerjes së veprimeve procedurale në lidhje me sekuestrimin e mjetit lundrues “gomone” me ngjyrë gri, me mbishkrimin “MAXI MATRICA”, e pamatrikulluar, me gjatësi 6.4 m, gjërësi 2.3 m, me dy motorrë, njëri model “ENVIRUDE” me fuqi motorrike 150 hp, ndërsa tjetri model “MARINER” me fuqi 15 hp, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm i përdorimit të këtij mjeti lundrues për qëllime kriminale(trafikim lëndësh narkotike), fakt i cili ka legjitimuar oficerët e policisë gjyqësore të kryenin sekuestrimin me iniciativë të sendit, duke ia dërguar për vleftësim prokurorit brenda 48 orëve, i cili nga ky moment dhe brenda 48 orëve ka vendosur vleftësimin si të ligjshmë të sekuestros.

Gjithashtu, gjykata çmon se, kërkesa për konfiskimin e sendit, është paraqitur brenda afatit prekluziv prej 15 ditësh të parashikuar nga ligji i posaçëm, nga momenti i vendosjes së sekuestros(datë 10.05.2014).

Për sa sipër, gjykata çmon se, kërkesa e paraqitur nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me konfiskimin e mjetit lundrues “gomone” me karakteristikat e përshkruara si më lart, është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

Gjykata, pasi u tërhoq për vendim dhe si u kthye, bazuar në nenet 379 e vijues të K.Pr.Penale, Ligjit Nr.8663, datë 18.09.2000 “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT”.

VENDOSI:


1. Pranimin e kërkesës.
2. Konfiskimin e mjetit lundrues “gomone”, me ngjyrë gri, me mbishkrimin “MAXI MATRICA”, e pamatrikulluar, me gjatësi 6.4

m, gjërësi 2.3 m, me dy motorrë, njëri model "ENVIRUDE" me fuqi motorrike 150 hp, ndërsa tjetri model "MARINER" me fuqi 15 hp.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së tij.

U shpall sot, në Vlorë, më datë 28.05.2014.

**SEKRETARE
NILDA THANASKO**




**GJYQATAR
LAURENT FUÇIA**



Vendimi mori formë të prërë
pasi nuk u ankimua
më dt. 04. 06. 2014
Vlorë më dt. 18. 06. 2014

K / sekretare



2/14

Kancelare
Ezarta Tausha

